

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr.1522 Rep.  
Nr. 458 Kol

Taksa e pulles 700 leke u aplikua ne Kopirje e arkivit te noterit



## KONTRATE SHITBLERJE

Në Tiranë, sot me datë 12 Shtator 2018( Dymijë e Tetëmbdhjete), ditë e mërkurë, para meje noteres publike Rajmonda A.DYRMISHI, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë , me seli në Rrugën “Myslym Shyri”, P.72/1, shk.2, ap.25 u paraqitën personalisht, për redaktimin e një Kontrate Shitje dhe Blerje Kuotash të Kapitalit në bazë të nenit 705 e vijuesa të Kodit Civil; Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, palët si me poshte:

### SHITES:

**Znj.NIKEIDA ÇIKU**, shtetase shqiptare, atësia Sali, lindur më, 19.05.1983 në Tirane, banuese në Tirane, Njesia Bashkiake Nr.4, Rruga” Niko Avrami”, madhore e me zotësi te plotë për të vepruar, identifikuar nga dokumenti që më paraqiti Letërnjoftimin Nr. 03014410, me Nr. Personal I35519131K, lëshuar dt.12.11.2010, Dhe

**Z. KLODIAN ZAIMI**, shtetas shqiptar, atësia Qemal, lindur më, 29.07.1979 në Corovode, Skrapar, banues në Tirane, Njesia Bashkiake Nr.4, Rruga” Niko Avrami”, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga dokumenti që më paraqiti Letërnjoftimin Nr. 029303214 me Nr. Personal H90729127T, lëshuar dt.13.07.2010.

### Te Pranishem:

**Z. Ahmet Gjinishi**, shtetas shqiptar, atësia Tasim , lindur më, 02.02.1980 në Peqin, Elbasan, banues në Tirane, Njesia Bashkiake Nr.4, Rruga” Niko Avrami”, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga dokumenti që më paraqiti Letërnjoftimin Nr. 027751891, me Nr. Personal H80202025Q, lëshuar dt.16.10.2009 (bashkeshorti i pales shitesse znj. Nikeida Çiku), dhe

**Znj. Ema Zaimi** shtetase shqiptare, atësia Fran, lindur më, 03.12.1980 ne Elbasan, banuese ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr.4, Rruga” Niko Avrami”, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga dokumenti qe me paraqiti Leternjoftimin Nr.033422959, me Nr. Personal I06203006U, lëshuar dt.29.06.2012 ( bashkeshorte e pales shitesse Klodian Zaimi).

### BLERES:

**Z.GERT PUSTINA**, shtetas shqiptar, atësia Arjan, lindur më, 01.12.1980 në Tirane, banues në Tirane, Rruga “Myslym Shyri” P.9, Ap.32, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga dokumenti që më paraqiti Letërnjoftimi Nr.033356317 me Nr.Personal I01201051S, lëshuar dt. 05.04.2017.

J. Zaimi

Em

Palët me vullnetin e tyre të lire, të plotë dhe në mirëkuptim të ndërsjelltë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate, në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme ;

#### **TE DHENA PARAPARAKE:**

Sipas ekstraktit historik të Regjistrisë Tregtar për të dhënat e subjektit "HYDROWATER-ALBANIA" sh.p.k, regjistruar date 14/12/2011, NIPT-in L12414005A , rezulton se Shitesit ne kete kontrate jane ortake te shoqerise dhe zoterues te pjeseve te kapitalit si vijon;

1. Nikeida Çiku , zoteron:

-Vlere kapitali ne Para : 60.000,00 (gjashtedhete mije)

-Numri i pjeseve 60,00

-Pjesemarja ne perqindje (%) 60,00

1. Klodian Zaimi , zoteron:

-Vlere kapitali ne Para : 40.000,00 (dyzete mije)

-Numri i pjeseve 40,00

-Pjesemarja ne perqindje (%) 40,00

**Me vendimin Nr.3,Date 12/09/2018 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "HYDROWATER - ALBANIA" sh.p.k eshte miratuar shitja e kuotave ;**

1. Znj.Nikeida Çiku zoteron dhe i shet Z. Gert Pustina:

-Vlere kapitali ne Para : 60.000,00 (gjashtedhete mije)

-Numri i pjeseve 60,00

-Pjesemarja ne perqindje (%) 60,00

2. Klodian Zaimi , zoteron: dhe i shet Z. Gert Pustina :

-Vlere kapitali ne Para : 40.000,00 (dyzete mije)

-Numri i pjeseve 40,00

-Pjesemarja ne perqindje (%) 40,00

Ne baze te Udhezimit Nr.2007/1 date 02.03.2010 te Ministrise se Drejtesie eshte kerkuar informacion nga noteri sipas njoftimit "D" prane Regjistrin te Barreve Siguruese dhe nga pergjigja e dhene nga RBS ne Nr. dokumenti date 12.09.2018, rezulton se mbi kuotat e shoqerise "HYDROWATER-ALBANIA" sh.p.k si dhe mbi vete kuotat e pales shites,e nuk rezulton te kete asnje barre siguruese.

#### **NENI 1 – OBJEKTI**

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e kuotave ne kete shoqeri nga pala shitese sipas pjeseve takuese, pjesmarrjes ne perqindje me vleren e kapitalit fillestar,me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria ka ndaj te treteve qofshin institucione shtetore apo persona juridik dhe fizike si dhe individe, vendas apo te huaj, nga Shitesit ne favor te Bleresit , si vijon;

#### **NENI 2 - ÇMIMI**

2.1 Shitesi, Nikeida Çiku i shet kuotat e kapitalit bleresit Gert Pustina ne vleren 60.000,00 (gjashtedhete mije) leke .

2.2 Shitesi,Klodian Zaimi i shet kuotat e kapitali bleresit Gert Pustina ne vleren 40.000,00 (dyzete mije) leke.

The bottom of the page contains several handwritten signatures in blue ink. From left to right, there are four distinct signatures. The first one appears to be 'Klodian Zaimi'. The second is a stylized signature. The third is another stylized signature. The fourth is a signature that looks like 'Gert Pustina'.

- 2.3 Palet deklarojne se cmimi eshte paguar i plote ne para fizike (cash) jashte kesaj zyre noteriale nga Bleresi ne favor te Shitesve per vlerat respektive te secilit dhe keta te fundit deklarojne se jane likujduar nuk kane asnje pretendim

### NENI 3 - TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE .

- 3.1 Shitesit garantojne Bleresin per titujt e pronesie te pasurise objekt i kesaj kontrate dhe per saktesine e dokumentacionit ligjor zyrtar te saj.
- 3.2 Shitesit jane te detyruar ti dorezojne pasurine objekt i kesaj kontrate me te gjitha dokumentacionin origjinal perkates Bleresit me marrjen e pageses nga ana e ketyre te fundit.
- 3.3 Shitesit jane te detyruar te dorezojne pasurine objekt i kesaj kontrate Bleresit, i cili pranon blerjen e pjeseve takuese te kuotave dhe kapitalit ne kete shoqeri me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe kjo shoqeri ka ndaj te treteve qofshin keto institucione shteterore apo persona juridike dhe fizik si dhe individe , vendas apo te huaj.
- 3.4 Me regjistrimin e kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB ), ortaket qe shesin kuotat per pjeset takuese te secilit nuk kane asnje te drejte dhe pretendim mbi pjesen e kuotave te shitura te Shoqerise "HYDROWATER-ALBANIA " shpk.

### NENI 4 - KALIMI I PRONESISE


- 4.1 Me nenshkrimin e kontrates, regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit ,Shitesi Nikeida Çiku dhe Klodian Zaimi zhvishen teresisht per pjeset takuese te shitura nga pronesia mbi pasurine objekt kontrate dhe ato i kalojne teresisht Bleresit z.Gert Pustina i cili behet ortak i vetem I shoqerise" HYDROWATER-ALBANIA" shpk dhe zoterues ne ;
- Vlere kapitali ne Para: 100.000,00 (njqind mije)
  - Numri i pjeseve 100,00
  - Pjesemarja ne perqindje (%) 100,00

### NENI 5- TE NDRYSHME

- 5.1 Palet u vune ne dijeni sipas ligjit qe te depozitojne kete kontrate te transferimit te kutoave ne afat ligjore ne Qendren Kombetare te Biznesit ne Repubiken e Shqiperise.
- 5.2 Palet bien dakort, qe ti zgjidhin me mirekuptim, te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin per shkak te ekzekutimit te kesaj kontrate. Ne raste te kundert, nese mosmarrveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane .


Kontrata ju lexohet paleve, te cilet e degjuan, e kuptuan ,e pranojne permbajtjen e aktit dhe e nenshkruajne ate pa verejetje, duke vene emrin dhe mbiemrin, ne forme nenshkrimi kjo e percaktuar ne nenin 46 te Ligjit Nr.7829, date 01.06.1994" Per Noterine " ( I ndryshuar) .

Kontrata hartohet ne 4-kopje origjinale , me permbatje dhe vlere te njejte juridike , nga te



3 | Page

cilat nje kopje ruhet ne arshiven e noteres dhe kopje e tjera ju jepen paleve. Une noteria ,  
vertetoj redaktimin korrekt te aktit dhe vertetesine e nenskrimeve te paleve sipas ligjit.



PALET

SHITES

Nikeida Çiku  
NIKEIDA ÇIKU

BLERES

Gert Pustina  
GERT PUSTINA

Klodian Zaimi  
KLODIAN ZAIMI

Te pranishem:

Z. Ahmet Gjinishi  
Ahmet Gjinishi

Znj. EMA ZAIMI  
Ema Zaimi



NOTERE  
Rajmonda Djanishi

**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20180912143044372  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 12.09.2018  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 2:30:44PM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-253-586  
Referenca e Perdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

HYDROWATER-ALBANIA SH.P.K.



*Arta Durr*

HYDROWATER-ALBANIA

Njesia Administrative Nr.5, Rruga "Sulejman Delvina", Nderresa Nr.1, Hyrja 22, Ap.28, Kodi Postar 1019, Tirane  
NUIS: L12414005A  
TEL/0699956728

HYDROWATER-ALBANIA sh.p.k

12/09/2018

NIPT: L12414005A

Lenda: Shitje-Blerje Kuotash

Drejtuar: QKB (Qendra Kombetare e Biznesit)

V E N D I M

**Nr. 3 Date 12/09/2018**

Sot me date **12/09/2018** ne seline e saj u mblodh Asambleja e Ortakeve te shoqerise "HYDROWATER-ALBANIA sh.p.k" me NIPT L12414005A, te perfaqesuar nga Z. Klodian Zaimi dhe Znj. Nikeida Çiku

Pasi moren ne shqyrtim rendin e dites:

- Diskutim mbi ecurine e veprimtarise se shoqerise
- Shitjen e 60% te kuotave te shoqerise qe zoterohen nga ortaku **Nikeida Çiku** dhe shitjen e 40% te kuotave te shoqerise qe zoterohen nga ortaku **Klodian Zaimi** tek bleresi **Gert Pustina**

Vendosen:


1. Shitjen e 60% te kuotave te shoqerise qe zoterohen nga ortaku **Nikeida Çiku**
2. Shitjen e 40% te kuotave te shoqerise qe zoterohen nga ortaku **Klodian Zaimi**
3. Z. **Gert Pustina** blen 60% te kuotave qe zoterohen nga Znj. **Nikeida Çiku**
4. Z. **Gert Pustina** blen 40% te kuotave qe zoterohen nga Z. **Klodian Zaimi**
5. Ortak i vetem i shoqerise **HYDROWATER-ALBANIA sh.p.k** do jete **Gert Pustina**

Administratori i shoqerise Z.**Gert Pustina** autorizon Z. **Ergys Dervishi** te ndjeke procedurat ligjore per dorezimin e vendimit dhe kontraten e shit-blerjeve te kuotave prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane.

**Nikeida Çiku**

*Nikeida Çiku*  


**Klodian Zaimi**

*KLODIAN ZAIMI*  


**Gert Pustina**

*Gert Pustina*  
